



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 127 prot.

Shkodër, më 07/06/2024

VENDIM 18.

PËR RREZIMIN E ANKESËS SË DR. ARLINDA YMERI

Ankues: Dr. Arlinda Ymeri, pedagoge në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, Departamenti i Mësuesisë, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi".

Objekti i Ankesës: Ankim ndaj vendimit nr. 4, datë 04.06.2024 të Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Shkencave të Edukimit, dhe kërkesa për shfuqizimin e pjesshëm të këtij vendimi për sa i përket pikës 6, si dhe skualifikimin e Dr. Pranvera Kraja si kandidate për Autoritetin Drejtues të Njesisë Bazë, Departamenti i Mësuesisë, për shkak të mospërmbushjes së kriterëve të parashikuara në nenet 11 pika 6 dhe 33 pika 4 të Statutit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi".

Baza Ligjore: Nenet 11 pika 6 dhe 33 pika 4 të Statutit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"; Neni 109 i Kodit të Procedurave Administrative; Neni 11 paragrafi 1 shkronjat "f" dhe "g" të Kodit të Punës.

Lënda: Ankesë Data: 05.06.2024 Drejtuar: Komisionit Institucional Zgjedhor

Baza ligjore: Neni 36 i Vendimit Nr. 106, datë 20.02.2020, i ndryshuar

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE (KIZ)

Në mbledhjen e datës 07.06.2024, Gjatë shqyrtimit të dy ankesave me të njejtin objekt dhe nga e njeja ankuuese, Dr. Arlinda Ymeri ndaj vendimit Nr. 4 të KZF-FSHE datë 04.06.2024, duke u bazuar në:

- Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; neni 45.
- Statutin e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"; neni 33.
- Rregulloren për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në USH.; neni 21, paragrafi 1, 2 dhe 3.

KONSTATON:

Se Dr. Arlinda Ymeri kandidate për Drejtuese e Njesisë Bazë, Departamenti i Mësuesisë është ankuar kundër vendimit nr.4, datë 04.06.2024 i Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Shkencave të Edukimit për mosplotësimin e kriterit të përvojës/vjetërsisë në punë si mësimdhënëse në Arsimin e Lartë parashikuar nga neni 33 i statutit të USH-së nga kandidatja Dr. Pranvera Kraja. Gjatë verifikimit të dokumentacionit të kandidates Dr. Pranvera Kraja të ardhur nga KZF-



FSHE me shkresen protokolluar në KIZ me nr. 122 datë 7.6.2024, vëren vërtetimin e lëshuar nga punëdhënësi, Rektor Prof. Dr. Rajmonda Këçira.

Sipas këtij vërtetimi Dr. Pranvera Kraja është punësuar me kohe të plotë në Departamentin e Mësuesisë, Fakultetin e Shkencave të Edukimit me datë 10.01.2020 (gjatë vitit akademik 2019-2020) dhe si pedagoge e jashtme që nga viti akademik 2005-2006 deri në 2019-2020. Të dhënat e mësipërme sipas vërtetimit të rektores janë nxjerrë nga sektori i burimeve njerëzore të Ush-së. Përveç këtyre në dokumentacionin e saj (përcjellë nga KZF-FSHE) rezulton se ka fotokopjen e diplomës së doktoraturës, të mbrojtur me datë 05.05.2016. Me këto të dhëna të dokumentuara rezulton se Dr. Pranvera Kraja plotëson kriterin vjetërsi në punë në arsimin e lartë, konkretisht 5 vite punë akademike, 4 vite e pesë muaj kalendarike si pedagoge e brendshme dhe 15 vite si pedagoge e jashtme. Te gjitha këto të dhëna plotësojnë kriteret e nenit 45 të ligjit Nr. 80/2015, nenit 33 të statutit të Ush-së, nenit 21 paragrafi 1, 2, 3 të rregullores për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në USH.

Në gjykimin tonë si anëtarë të KIZ këto janë prova të mjaftueshme për plotësimin e kriterit të përvojës në mësimdhënie, për një kandidat, që garon për drejtues të njësisë bazë, si dhe lënien në fuqi të vendimit nr.4, datë 04.06.2024 të Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Shkencave të Edukimit. Për këto arsye KIZ.

VENDOS:

1. Rrëzimin e ankesës së Dr. Arlinda Ymeri si të pabazuar në ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Statutin e Universitetit të Shkodrës dhe RregulloreN së Zgjedhjeve në USH.
2. Lënien në fuqi të vendimit nr.4, datë 04.06.2024 të Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Shkencave të Edukimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjherë.

Sekretare
Ermira Kuluri

Anelmo Spahija

Gasper Kokaj

Peter Saraçi



Kryetar

Fatjon NURJA

Irini Dibra

Sebastjan Mjekaj

Marjan Curri